Nr. 11-1011 Data 30.09.2019

Republika e Kosovës- Republika Kosovo- Republic of Kosova

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetqeverisjen lokale ( Gazeta Zyrtare nr.28 te dt.04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, neni 14 paragrafi 7 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit ZKA ( nr.1163 te dt.21.06.2019 ), Kryetari i Komunës, më 30.09.2019 merr këtë:

# VENDIM

**I. Caktohet Fitore Hashani /Drejtore e DMM-së person kontaktues për të bashkëpunuar me Zyrën Kombëtare të Auditimit me qëllim të zbatimit të Planit të veprimit për vitin 2018.**

**II. Zyrtarja e emëruar është e detyuruar t'i kryejë detyrat e monitorimit dhe zbatimit të Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2018, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.**

**III. Ky vendim hynë në fuqi që nga dita e nënshkrimit.**

T'i dorezohet
- Kryetarit të Komunës
- drejtorit të DMM
- drejtorit të DEFZH
- Zyres Kombëtare te Auditimit
- arkivit

Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazna
Nr-/Br. 11-1005 Data/Datum 30.09.2019
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës-Republika Kosovo- Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

| | |
|---|---|
| Datë | 30.09.2019 |
| Për | Zyra Kombëtare e Auditimit |
| Nga | Kryetari i komunës-Xhafer Gashi |
| Lënda | Raporti për zbatimin e rekomandimeve |

Përshendetje,

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e Auditimit dhe planeve të veprimit, rregullorja nr.1163 e dt.21.05.2019, pranoni raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit (ZKA), për komunën e Obiliqit.

Të bashkangjitur gjeni raportin.

Faleminderit për bashkpunim!

Me respekt!

**Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit (ZKA), për Komunën e Obiliqit, viti financiar 2018**

| Nr. | Komponentat e auditimit | Rekomandimet | Veprimi i menaxhmentit | Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimeve | Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht, i | Sfidat në zbatimin e rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PFV | Kryetari duhet të angazhohet që gjatë planifikimit të buxhetit për organizatën të vlerësohen nevojat reale të komunës me qëllim që të bëhet një planifikim adekuat i buxhetit dhe të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve nëpër kategori ekonomike. | Angazhim shtesë nga të gjitha njësitë në planifikimin e buxhetit sa më real në të gjitha kategoritë ekonomike | Për këtë vit gjatë buxhetimit janë bërë planifikimet e duhura dhe keq klasifikimet në çështjet e theksuara janë evituar përveç orëve shtesë për ndrrimet e natës nga vitet 2012-2013. | Pjesërisht i zbatueshëm | Çështja e orëve shtesë lidhet më shumë nga vitet paraprake dhe është e pamundur të evitohet brenda komizave ligjore (rregulloreve). |
| 2 | Planifikimi dhe realizimi i buxhetit | Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Ndërsa, planifikimi dhe shpenzimi për projekteve të caktuara duhet të bëhet konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve. | Inicimi i prokurimeve për projektet kapitale do të bëhet me kohë duke u bazuar në planin e prokurimit publik për vitin përkatës (Për vitin 2019 trendi i inicimit të prokurimeve është në nivel të kënaqëshëm), do të ngritet niveli i kontrollës për zbatimin e kodeve ekonomike gjatë shpenzimit të buxhetit. | Gjatë planifikimit është tentuar një planifikim sa më real për 2019. Sipas parashikimeve pritjet janë që të ketë një rritje të realizimit të buxhetit në krahasimme vitin paraprak. | Pjesërisht i zbatueshëm | |
| 3 | Planifikimi dhe realizimi i buxhetit | Kryetari, duhet të siguroj kontrolle, përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara | Do të ngritet niveli i kontrolleve të brendshme në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, që obligimet ndajë operatorëve të kryhen me kohë dhe të shmangen kontestet gjyqsore/përmbarimore. | Përveç orëve shtesë për mjekët, i kemi evituar rastet tjera. | Pjesërisht i zbatueshëm | Obligimet nga vitet paraprake në lidhje me orët shtesë e pamunduar të evitohen sepse janë përmes gjykatave (shih komentin e parë). |
| 4 | Pagat dhe mëditjet | Kryetari të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të bëhën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Në rastet kur ka deficit të burimeve njerëzore, kjo duhet të konsultohet me organet përkatëse qendrore (ministrinë përkatëse) dhe rastet e tilla të rregullohen përmes bazës rregullative. | Rekrutimet çdo here mundohemi t'i bëjmë duke u bazuar në aktet ligjore në fuqi, praktikë kjo që do të vazhdojë duke e ngrit nivelin e kontrollit. | janë marrë masa dhe për të gjitha konkurset tani veprohet sipas rregulloreve në fuqi. Ligji I Obiliqit nuk do të përdoret më si kriter, meqenëse ky ligj është I dedikuar vetëm për pozitat në sektorin e minerareve. | E zbatuar | |
| 5 | MSHV | Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave. | Me rritjen e buxhetit të komunës, me Ligjin për Obiliqin (Ligji nr.05/L-044), është rritë nevoja për staf shtesë, prandaj jemi obliguar të angazhojmë punonjës me MSHV, duke i respektuar procedurat ligjore të cilat do të respektohen edhe në të ardhmen nëse paraqiten nevojat e tilla. Me planifikimin e KASH ne e bëjmë planifikimin real për paga dhe meditje, mirëpo me qarkoren e dytë buxhetore MF, bënë shkurtimin e buxhetit në kategorinë ekonomike Paga dhe Meditje dhe ne jemi të detyruar të ruajmë kufijtë buxhetor për secilën kategori ekonomike, gjë që në raste të caktuara na pamundëson pagesën e meditjeve nga sistemi i pagave. | Ka përmirësime në 2019 dhe kemi tentuar që të gjitha pozitat e mbuluara përmes kontrates mbi vepër t'i parashohim në buxhetin e 2019 | pjesërisht i zbatueshëm | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë që asnjë punë të mos kryhet fillimisht pa lidhur kontratë dhe përcaktuar saktë kushtet dhe çmimet e punëve apo shërbimit të përfituar. | Gjithmonë para inicimit të secilit prokurim ZKA dhe ZKF nënshkruajnë Deklaratën e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve dhe punët kryhen dhe do të kryhen duke u bazuar në kushtet dhe çmimet e kontratës. Në rast të punëve shtesë do të lidhet aneks kontrata. | Gjatë vitit 2019 për të gjitha kontratat (punët shtesë), paraprakisht janë nënshkruar nënshkruar kontratat dhe kushtet në detaje. | E zbatuar | |
| 7 | Investimet kapitale | Kryetari të sigurojë se menaxherët e projektit kërkojnë nga kontraktuesit aplikimin e librit ndërtimor, si mjet për ndërtim dhe zhvillim të projektit. | Me rekomandimin tuaj është duke u aplikuar **Libri Ndërtimor** për ndërtim dhe zhvillim të projektit. | Për çdo projekt që nga fillimi i 2019 aplikohet Libri Ndërtimor | E zbatuar | |
| 8 | Investimet kapitale | Kryetari të siguroj se para fillimit të procedurave të janë planifikuar projektet në tërësi, të zgjidhen të gjitha çështjet pronësore, në mënyrë që të mos ketë ngecje të projekteve dhe të pa realizuara. | Këtë vit janë marrë masa të duhura që projektet përfundimtare të bazohen në profezionalizëm, gjendjen në teren dhe statusin pronësor, praktikë kjo që do të vazhdojë. | Është filluar që projektet të planifikohen shumë më mirë dhe se gjatë planifikimit të merren të gjitha pengesat e mundshme në konsideratë (evitimi i pengesave të banorëve p.sh dakordimi/ pëlqimi paraprak nga banorët etj.) | E zbatuar | |
| 9 | Të arkëtueshmet | Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Po ashtu komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një softueri për menaxhimin e tyre. | Për të arkëtueshmet kemi shpëmdarë vërejtje gjë që ka pasur efekt pozitiv, njëjtë do të vazhdojë edhe me angazhimin shtesë dhe në periudhën e dytë të vitit do të fillojmë me pëdorim të masave ndëshkuese përmbarimore. Jemi duke bërë analiza edhe për një softuer për menaxhimin e të arkëtueshmeve. | Masat e ndërmarra: 1.Në lidhje me tatimin në pronë, është duke përpiluar procedura për definimin se si të veprohet në rast se ka vonesa në pagesa nga tatimpaguesit, p.sh. Kur duhet dërgohet vërejtja me shkrim, në cilat raste (shuma, ditët në vonesa) duhet të shkoj lënda në përmbarim.<br>2. Në lidhje me tatim në biznes dhe qerat, komuna është duke e bërë ndarjen në borgjet e vjetra për të cilat bizneset nukjanë më aktive dhe ato aktive. Lista me borgje në biznese jo aktive do të propozohet në kuvendin komunal për shlyerje ndërsa për listat me biznese aktive do të përpilohet [illegible] | Pjesërisht i zbatueshëm | |
| 10 | NJAB | Kryetari duhet të konsiderojë që me krijimin e kushteve buxhetore, të planifikojë staf shtesë në NjAB me qëllim të funksionalizimit të plotë të kësaj njësie dhe të realizimit të planit vjetor. Njëkohësisht, që NjAB të përfshijë më shumë auditime me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në procesin e menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes. | Komuna në vazhdimësi bënë përpjekje për ngritjen e kapaciteteve në rritjen e nivelit të kontrollit të brendshëm, e në veçanti Auditimit të Brendshëm duke pasur parasysh numrin e kufizuar të puntorëve që iu lejohet komunave nga MAP dhe MF, ne në afatë ligjorë do t'i rrisim burimet në NjAB sipas Nenit 5, të Rregullores QRK-NR 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksionit të Auditimit të Brendshëm në SSP. | Është paraparë një auditor shtesë në buxhet gjatë fillimit të vitit 2020. | E pazbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Raportimi Menaxherial | Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, të arkëtueshmet, shpenzimet e IK, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të monitorojë listën e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara. | Forma e raportimit financiar dhe operativ është duke u zbatuar te menaxhmenti i lartë për të arkëtueshmet, shpenzimet nga të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë edhe IK. Raportimet nga seicila drejtori janë të rregullta dhe në vazhdimësi do të përcillet vijueshmëria e realizimit të planit të prokurimit, planit të shpenzimeve dhe planet operative të çdo drejtorie. | Në kfartalin (tre mujorin)e katërt, komuna dotë analizojë procesin e raportimit financiar dhe se si ky mund të përmirësohet për të vënë nën kontroll të pranueshme rreziqet potenciale. | Pjesërisht e zbatuar | |

Xhafer Gashi. Krvetar i Komunës